



Republika e Kosovës/ Republika Kosova
Republic of Kosovo
Komuna Istog/ Opstine Istok/ Municipality of Istog
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



12 Nr. 09 /2026

Datë 10.03.2026

Thirrje publike për shprehje të interesit për të qenë pjesë e komisionit vlerësues. Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare për projektet/programet e OJQ-ve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Bazuar në njoftimin e datës 24.02.2026 të publikuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - Komuna e Istogut për Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare për projektet/programet e OJQ-ve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Ftojme përfaqësuesit e organizatave jo qeveritare/shoqërisë civile dhe ekspertët, të aplikojnë për të marrë pjesë në komisionin e vlerësimit, në cilësinë e ekspertit të jashtëm.

Për këtë qëllim, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport fton të gjithë kandidatët e interesuar të aplikojnë për të qenë pjesë e komisionit vlerësues si ekspertë të jashtëm për të vlerësuar aplikimet e paraqitura nga OJQ-të pas njoftimit publik të bërë nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Angazhimi i ekspertit të jashtëm për procesim e vlerësimit është me pagesë në shumën prej 80 euro (tetëdhjetë euro).

Të drejtën për të aplikuar kanë:

- Punonjësit të organizatave joqeveritare që veprojnë në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur me përvojë pune në ndonjëren nga fushat e caktuara.

Aplikantët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Duhet të kenë të paktën nivelin e studimeve themelore universitare - Bachelor;
- Dëshmi të përvojës së punës;
Përvojë dhe njohuri në fushat e caktuara
- Nuk duhet të jenë të emëruar politik, nëpunës civilë ose në pozita të ngjashme në administratën publike;

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- Letër motivimi;
- CV e azhurnuar;
- Provat e arsimimit dhe të përvojës së punës;
- Punonjësit e OJQ-ve duhet të paraqesin një letër nominimi nga udhëheqësi i OJQ-së në të cilën është i punësuar aplikanti.

I tërë dokumentacioni i nevojshëm duhet të dërgohet vetëm përmes adresës elektronike

e-mail; drin.sadikai@rks-gov.net

Për informacion shtesë mund të njoftoheni me telefon: 046 261 040

Vetëm kandidatët nga lista e shkurtër do të kontaktohen.

Afati i aplikimit është i hapur 5 ditë pune nga data e publikimit, nga 11.03.2026 deri më 16.03.2026 Aplikacionet që vijnë pas afatit dhe aplikacionet jo të plota do të refuzohen.

Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport

znj. Era Rexhaj



E. Rexhaj